



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 16/44 Prot.

Tiranë më, 30.06.2017

VENDIM

Nr. 83, datë 30.06.2017

PËR ZBATIMIN NGA STRUKTURAT E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
TË REKOMANDIMEVE TË ADRESUARA NGA MISIONET E ZHVILLUARA NË
KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT IPA 2013
“FORCIMI I KAPACITETEVE TË AUDITIMIT TË JASHTËM”

Bazuar në nenin 25 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në kuadër të angazhimeve të marra nga KLSH për implementimin e projektit të binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”, i cili synon përputhjen e veprimtarisë audituese me standardet ndërkombëtare të auditimit praktikat më të mira të fushës dhe modernizimin e institucionit,

VENDOSA:

1. Miratimin e planit për zbatimin nga strukturat e Kontrollit të Lartë të Shtetit të rekomandimeve të adresuara nga misionet e zhvilluara në kuadër të implementimit të projektit të binjakëzimit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”.
2. Për zbatimin e Planit të Veprimit ngarkohen: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorët e Drejtorive.
3. Me ndjekjen e ecurisë së zbatimit të këtij plani ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Bujar LESKAJ

